

- 2** **Kriza e koronës godet më së shumti migrantet/ët**
Nevojitet një fond për përballim pasojash
- 3** **Portreta punëmarrësesh/ish në kohë pandemie**
Migrantet/ët kujdesën për funksionimin e vendit
- 4** **Pyetje dhe përgjegje në lidhje me pandeminë**
Informacione mbi të drejtat tuaja gjatë krizës së koronës

Nr. 3 | mai 2020 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Kriza e koronës dhe asistencë sociale

Rreziqet për sigurinë e qëndrimit të huajve



Migrantet/ët në Zvicër me punën e tyre kontribuojnë për funksionimin e shumë shërbimeve shoqërore dhe për vendin

Me rastin e krizës së koronës shumë punëmarrës humbin të ardhurat e tyre deri diku të sigurta. Shumë të huaja dhe të huaj punojnë në sektorët dhe degët me paga të ulëta. Për të mbyllur zbrazëtite buxhetore, ata janë të detyruar të marrin ndihmë sociale. Kjo bien rrezik për sigurinë e lejes së qëndrimit.

Hilmi Gashi

Nëse punëmarrësit shkak i punës me kohë të shkurtuar, apo papunësisë marrin vetëm 80% të të ardhurave të tyre të deritashme, atëherë atyre ju duhet – si zgjidhje e fundit – të mbyllin zbrazëtite buxhetore me ndihmë sociale. Kryetari i konferencës së asistencës sociale llogarit me dhjetëra-mijëra marrës të ri të asistencës sociale. Këto janë shenja të për atë, se rrjeti i sigurisë së ndërtuar nga Qeveria Federale me 20 mars është i pamjaftueshëm. Punëmarrësit në kushte të vështira e të pasigurta të punës bien në rrjet: për shumë migrante e migrant, para së gjithash për të tillë me status të pasigurt qëndrimi, kjo domethënë siguri të pandërprerë dhe rrezik për humbjen e të drejtave të qëndrimit.

Gjendja e pasigurisë permanente

Shumë nga anëtarët tanë kanë frikë se do të humbin lejen e tyre vjetore apo të përhershme të qëndrimit, nëse

shkak i krizës së koronës dhe të ardhurave të pamjaftueshme duhet të marrin ndihmë sociale. Ligji për të huajt parasheh mundësinë e heqjes së lejes së qëndrimit apo degradimin e lejes së përhershme, nëse të huajt nuk përmbushin kriteret e integritimit sipas Nenit 58a të AIG/LEI (ligjit për të

ta lëshojë Zvicrën. Pasi kjo mund të vlerësohet si gatishtëri i pamjaftueshme integrimi dhe të dënohet me degradim apo heqje të së drejtës së qëndrimit.

Heqja e lejes së përhershme të qëndrimit C është e mundur edhe pas më

Ndihma sociale për shkak të koronavirusit nuk mund të interpretohet si «mungesë integrimi»

huaj dhe për integrim): Si kriteri më i ashpër numëron marrja e ndihmës sociale. Kjo vlen si për qytetarët e të ashtuquajturave shtete të treta, ashtu edhe për ata të BE-së dhe EFTA-s. Humbja mund të ndodh drejtpërdrejt dhe nuk është e thënë të ndodh përmes degradimit. Kjo domethënë, nëse dikush nuk mund të dëshmojë «Vullnetin për pjesëmarrje në jetën ekonomike» dhe merr ndihmë sociale duhet të llogaritet që duhet

se 15 viteve qëndrimi: Pas humbjes së lejes vjetore B të qëndrimit, personi i prekur duhet të lëshojë Zvicrën.

Marrja e ndihmës sociale pengon pozitën më të mirë

Personat e pranuar përkohësisht me leje F në rrethana të caktuara të konvertojnë lejen F në leje vjetore të qëndrimit B. Kjo gjithashtu është e ndërlidhur me kriteret integruese. Nëse dikush merr ndihmë sociale, kjo

do të vlerësohet si mungesë integrimi dhe kështu të refuzohet konvertimin. E njëjta vlen edhe për natyralizimin. Kush merr, apo ka marrë ndihmë sociale, nuk mund – varësisht nga Kantoni 3–10 vjet – të aplikojë për shtetësi. Kush vetëm se ka aplikuar, nuk do të natyralizohet. Sekretariati për migracion duhet të veprojë

Sekretariati për migracion (SEM) është i vetëdijshëm për këtë problematikë. SEM u kërkon kantoneve të «tregojnë vullnet të mirë» kur bëhet fjalë për ndihmë sociale. Kjo nuk mjafton. Nevojitet një urdhëresë e qartë dhe detyrueshme për kantonet dhe komunat. Unia kërkon nga SEM, që rastet e marrjes së ndihmës sociale gjatë periudhës së krizës së koronës nga autoritetet nuk guxon të interpretohet si mungesë integrimi. Kërkohej një moratorium prej 1 viti për të zbatuar kriteret e integritimit sipas AIG/LEI Neni 58a si dhe mos pengim apo disfavorizim me rastin e ndarjes së lejeve shkak i krizës së koronës

Editorial



Solidar në krizë

Kriza e koronës formëson përditshmërinë tonë. Sfidat janë të mëdha. Më së ndjeshmi megjithatë kriza godet njerëzit, të cilët i takojnë grupeve të cënueshme. Këtu gjinden shumë migrant/e me apo pa status të rregulluar.

Në mes të marsit ministria Simoneta Samaruga tha: «Ne nuk do tu lëmi vetëm. Ne do të kujdesemi për ju». Kjo tingëlloi si lehtësim dhe si qetësuese. Masat e para u ndërmorën. Dhe megjithatë, rrjeti i kujdesit përfshirës për të prekurit e shumë punëmarrës tregoi zbrazëtira të mëdha. Shumë të huaj me kontrata të pasigurta dhe pa vende pune mbeten të anashkaluar. Ata kanë frikë për mbijetesën dhe për të drejtat e qëndrimit.

Të huajt japin një kontribut themelor për stabilitetin ekonomik të Zvicrës dhe luftojnë me solidaritet në radhët e para kundër pandemisë. Pa punën e migrantëve/eve sektorët esencial të përkudjesjes themelore, si logjistika, tregtimi me pakicë, kujdesi, pastrimi dhe shumëçka tjetër, s'do të funksiononte fare. S'duhet harruar se ata me këtë rast i nënshtrohen rrezikut të infektimit. Në një situatë të tillë, përkeqësimi i të drejtave të tyre në planin e shkurt, të mesëm e afatgjatë nuk është as me dinjitet e as e mençur. Tani nevojitet solidariteti. Kurrkush nuk duhet të harrohet e anashkalohet.

Andaj, Unia kërkon nga Qeveria Federale, që fjalët të zbatohen në vepra dhe të vendoset krijimi i një fondi përballimi kalimtar për këta njerëz të prekur në mënyrë të veçantë. Marrja e ndihmës sociale nuk do të duhej të qonte në shkurtimin dhe humbjen e të drejtave të njerëzve dhe të shkatërrohet perspektiva e tyre në të ardhmen.

Hilmi Gashi


News

1 maji 2020: «Solidaritë, tani më shumë se kurrë!»

1 maji sivjet është zhvilluar ndryshe në këto 130 vitet e fundit. Manifestimet në rrugë – sivjet nuk ishin të mundshme. Mirëpo, për përparim shoqëror, për drejtësi, për tu përleshur më fortë për të drejtat e më të dobëta, kjo është e domosdoshme, më urgjente se herëve tjera. Ky Një Maj, duke pasur parasysh rrethanat, është zhvilluar para së gjithash në rrjetë – pos tjerash përmes diskutimeve-online, manifestim të drejtpërdrejtë përmes rrjetit me folës dhe mysafirë interesantë – për të ngritur zërin: për më shumë solidaritet! Aty ku ndërmarrjet shkarkojnë punonjësit edhe përkundër ndihmave me miliarda për ekonomi, ku dividendët për aksionarë shpërndahen pa masë, përdërisa punonjësit janë në punë me kohë të shkurtuar, ku pa marrë në konsideratë shëndetin e grupeve të rrezikuara thirren për të shkuar në vendin e punës, aty nevojitet një veprim i fuqishëm: Solidaritet, tani më shumë se kurrë! Më shumë informacione në: www.mai2020.ch

Risi koronavirusi: materiale shkarkuese në gjuhë të ndryshme

Rregullat higjienike dhe të sjelljes, përmes të cilave në mund të mbrohemi nga infektimi me koronavirusin e ri, tani janë në dispozicion edhe si video dhe fletëpalosje në gjuhë të ndryshme. Më shumë informacione dhe fletëpalosje faktike mbi koronavirusin – edhe mbi vet-karantinën – mund ti shkarkoni dhe shpërndani më tej nga ueb faja e Entitit Federal për Shëndetësi edhe në gjuhët e migrantëve e migrantëve të Zvicrës. Fletëpalosjet me fakte mund të shkarkohen në gjuhët vijuese: shqip, amharish, arabisht, farse, gjeorgjiane, kurmanqi, mandarin, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, boshnjakisht-kroatish-serbisht, sllovake, somaleze, spanjolle, tamile, tibetiane, tigrinya, turke, hungarez. <https://bit.ly/2KELKua>



Investimi tek të rinjtë, gjenerim për një të ardhme të fortë

Marrë parasysh krizën e koronës pjesëtarët e rinj të botës së punës, shëgjertët i nënshtrohen sfidave të jashtëzakonshme. Kërkesa për të mësuar aftësi profesionale dhe shkollore, megjithëse kushtet e ndryshme kornizë, varësisht nga ndërmarrja dhe dega industriale, rezultojnë në pabarazi të mëdha, lindin nevojën për zgjidhje specifike. Mbi bazën e tyre, u bënë thirrje me zë të lartë për përmirësimin e këtyre kushteve kornizë në kuptimin e shanseve të barabarta dhe me ndihmën e partnerëve social u hartuan rekomandime e sugjerime. Më 16.04.20 qeveria federale vendosi masa uniforme për provimin përfundimtar të profesionit dhe përfshirjen e nxënësve në kompensimin e punës me kohë të shkurtuar. Sidoqoftë, shumë pyetje mbeten pa përgjigje: Si do tu garantohet nxënësve mbështetje shkollore në sektorët industrial me rëndës relevante sistemore? Si shpërblehen orët e tepërta jashtë orarit? Si mund të përballohet boshllëku digjital me rastin e të mësuarit në distancë në shkollën profesionale, veçanërisht për nxënësit me një sfond migracioni, e me resurse të vështira familjare dhe statusin e azilkërkuësit?

Kriza e koronës godet më së shumti migrantet/ët Nevojitet fond përballimi kalimtar

Kriza e koronës pa dyshim ka shkaktuar vuajtje njerëzore. Migrantet e migrantët shpesh janë shumë më shumë të prekur shkak i lejes së tyre të qëndrimit. Unia kërkon për të gjithë të prekurit një fond përballimi kalimtar.

Hilmi Gashi

«Sezonierët e ri», siç quhen ndryshe njerëzit me lejen L, aktualisht janë pa asgjë dhe të humbur. Për arsye të mbylljes së gastronomisë dhe të ndërmarrjeve, shumë nga ta kanë humbur vendet e punës. Nëse nuk mund të dëshmojnë se kanë kontribuaer për kohë të mjaftueshme në sigurimin e papunësisë, apo kohën e tyre të kontributeve në njërin nga shtetet e BE/EFTA nuk mund ta dëshmojnë me formularin PD U1, mbesin pa të ardhura. Sigurimi i këtyre formularëve shkak i kizës së koronës është bërë i vështirë.

Komunat nuk i mbështesin të prekurit, apo edhe më keq, ato ua shkurtojnë atyre të drejtat e qëndrimit. Pas 6 muajsh papunë migrantet/ët humbin lejen e tyre L. Kjo godet veçanërisht fortë 20 000 veta, të cilët ka më shumë se 5 vite që, para së gjithash në kantonet kodrinore, punojnë e jetojnë me familjet e tyre. Urdhëresa e re e Qeverisë Federale mbi punën e shkurtuar edhe pse e merr parasysh këtë kategori, mirëpo vetëm nëse posedojnë një kontratë të vlefshme.

Kategoria e pasigurtë e shtetaseve të BE

Më së forti janë të goditur shtetasit/it e BE/EFTA, puna e të cilëve vetëm se është lajmëruar (kjo është e mundur përgjatë

3 muajve), apo personat, të cilët presin të ju lëshohet leja e qëndrimit. Këta nuk kanë të drejtë në sigurim papunësie apo ndihmë sociale. Shumë nga ta kanë humbur vendet e tyre të punës, apo nuk kanë të drejtë në kompensim për punë të shkurtuar. Ata tani faktikisht janë pa të ardhura në Zvicër. Kthimi në vendin e prejardhjes tani për tani është i pamundur shkak i mbylljes së kufijve dhe ndalimit të fluturimeve. Pos kësaj për të mundur të kthehen, ju nevojiten para, të cilat nuk i kanë.

Punëmarrësit pa letra

Personat pa letra, apo si quhen ndryshe Sans-papiers, që jetojnë në Zvicër nuk posedojnë leje qëndrimi. Ata janë të parët që kanë humbur vendet e tyre të punës dhe nuk kanë as të ardhura dhe as kanë të drejtë të përfitojnë nga masat federale.

Të parandalohen vështirësitë sociale

Për të mënjeluar vuajtjen njerëzore, nevojiten zgjidhje pragmatike. Kush nuk mund të përfitojë nga puna me kohë të shkurtuar, sigurimi i papunësisë dhe rregullorja e kompensimit të të ardhurave, mbetet pa para. Andaj, Unia kërkon nga Qeveria Federale një fond kalimtar përballimi, për të mbështetur njerëzit, të cilët edhe në kushte të vështira e të pasigurta kontribuojnë për ekonominë e Zvicrës dhe të cilët tani mbeten të anashkaluar.



Pamje nga aksioni i sindikalistëve të Unia në kuadër të fushatës «Edhe ne të gjithë jemi Zvicra!».

Unia Linja telefonike-korona Ndihe e menjëhershme juridike për punëmarrësit

Kur Qeveria federale shpalli «gjendjen e jashtëzakonshme» dhe kur u mbyllën ndërmarrjet, pati shumë punëmarrës të pasigurt. Në një kohë rekorde Unia ndërtoi linjën e menjëhershme telefonike, për të këshilluar juridikisht punëmarrësit shpejtë e pa komplikime. Edhe shumë migrant/e kanë shfrytëzuar linjën telefonike.

Marília Mendes

Rastet tregojnë, se gjatë krizës së koronës të punësuarit, që punojnë në shtëpi private, kujdesen dhe ndihmojnë në kryerjen e punëve, si dhe të tillë që punojnë në bazë të porosis e nevojës, janë të prekur në të veçantë. Këta shpesh janë migrant/e dhe veçanërisht gra migrante. Para krizës së koronës kishin një situatë të vështirë e të pasigurt, tani kanë mbetur krejtësisht

duarbosh, pasi ato nuk mund të përfitojnë as nga masat e Qeverisë Federale për tejkalimin e krizës.

Historitë e pasigurive

Portugezja nga Lozana, e cila sipas nevojës thirrje të pastronte hotelet, që nga fundi i shkurtit nuk ka pasur thirrje për të pastruar, andaj edhe nuk ka më të ardhura. Ajo nuk ka të drejtë në punë me kohë të shkurtuar. Dhe, pasi që është duke prituar marrjen e lejes e qëndrimit, nuk ka të drejtë në paratë e papunësisë.

E punësuar spanjolle në amvisni private nga Cyrihu ka halle të mëdha: Edhe pse kishte të drejtë ti paguheshin orët e zakonshme, mirëpo si ti kërkojë paratë nga shumë punëdhënës? Si do t'ia dali tani me obligimet e saja? Ajo ende nuk e ka arritur kohën e mjaftueshme të kontributeve, për të përfutur të drejtën nga fondit i sigurimit të papunësisë.

Kërkesat

Këto dhe shumë histori të ngjashme arrijnë tek Unia. Andaj, ne kërkojmë nga Qeveria Federale masa, për të evituar katastrofën humanitare dhe familjare (shih artikullin në po këtë faqe). Punëmarrësit, të cilët mbeten të anashkaluar, sikur Sans-papiers, të punësuarit në amvisni private, të punësuarit me thirrje sipas nevojës, migrant/e me leje të shkurtër qëndrimi, sipas kryetares Vania Alleva, duhet të mbrohen. Pos kësaj duhet që të sigurohet mbrojtja nga shkarkimi, para së gjithash të punonjësve në moshë të shtyrë.



Nevojitet ndihmë e menjëhershme për punëmarrësit

Puna e migranteve dhe migrantëve

Ruajtja e funksionimit të vendit

Edhe në kohë të pandemisë dhe Lockdowns duhet të ruhet funksionimi i shërbimeve të caktuara, për të garantuar jetën shoqërore. Një pjesë e madhe e kësaj pune «relevante për sistemi» kryhet nga migrantet e migrantët. Një pasqyrim.

Emine Sariaslan, Marek Wieruszewski, Osman Osmani, Marília Mendes

Semran Sancar, infermiere

Semran Sancar (50, e martuar, 3 fëmijë) punon në spitalin e Zofingenit. Profesionin e saj si infermiere e ka mësuar në Turqi, megjithatë në Zvicër nuk guxonte të ushtronte profesionin e vet, diploma e saj e infermierisë nuk ishte njohur. Fillimisht Samar ka punuar në fabrika të ndryshme. Me 2011 ka nisur të punojë si praktikante në një shtëpi pleqsh dhe ka filluar të mësojë gjermanishten (Diplomë B2). Më këtë ka bërë hapin e parë në ngritjen profesionale. Më vonë ka parashtruar kërkesën për njohjen e diplomës së saj. Pas dy vitesh asaj iu është njohur diploma, mirëpo e një shkalle më të ulët, pasi nuk vinte nga një shtet i BE-së. Si gjithmonë Samar ka vazhduar të punojë edhe gjatë krizës së koronës. Ajo ka punuar 2-3 fundjavë në mua. Ajo thotë: «Fëmijët e mijë janë të rritur, andaj nuk më është dashur të organizoj përkujdesjen për ta. Megjithatë unë duhet të jem tepër e vëmendshme, pasi që kam frikë, që këtë virus të koronës të mos e qoj në shtëpi». Ka koleg/e që i takojnë grupit të të rrezikuarve dhe të cilët kanë fëmijë, andaj ata duhet të qëndrojnë në shtëpi. Ne punojmë edhe për ta, andaj ne punojmë më shumë.



Semran Sancar, infermiere

Bejt Topalli, shofer taksie

Bejt Topalli, është 47-vjeç dhe baba. Ai është një muzikant i pasionuar dhe nga koha në kohë si muzikant profesionist ka siguruar jetesën. Ai jeton qe 30 vite në Zvicër dhe ka kryer punë të ndryshme, ndër të tjera si punëtor fabrike dhe i punësuar në hoteleri. Ka dy vite që Bejt Topalli është i punësuar me pagë në orë si shofer taksie (me një përqindje mes 40-50%) tek «Stadt Taxi Balaj».

Shkaku i pandemisë së koronës ai nga punëdhënësi që nga 15 marsi 2020 për arsye të Lockdown është dërguar në shtëpi. Punëdhënësi, edhe vet një migrant dhe bashkëvendës i Bejt Topallit, është edhe vet i sfiduar me situatën e re, përmes kontabilistit të tij ka lajmëruar punë me kohë të shkurtuar tek në javën e kaluar. Kështu, Bejt Topalli që nga 15 marsi nuk ka marrë asnjë monedhë pagë. Për fat të mirë e shoqja i punon ende dhe kështu kanë mundur ti paguajnë llogaritë e përhershme. Situata e tij, mbi një muaj pa punuar dhe edhe pa të ardhura, për te është tejet e vështirë.

Ky rast tregon se migrantet/ët, qofshin ata/o punëmarrës/e apo punëdhënës/e me rastin e krizës së koronës janë tejet të sfiduar dhe të disfavourizuar.



Bejt Topalli, shofer taksie

Lília, fuqi pastruese në spital

Unë quhem Lília dhe ka 8 vite që jam në Zvicër. Në Portugali isha specialiste e telekomunikacionit, tani këtu punoj si pastruese në spitalin e fëmijëve në Luzern. Këtë punë e kryej me kënaqësi. Atmosfera në spital është shumë e mirë, në trajtëmi që të gjithë njëjtë. Puna ime është e rëndësishme, në spital vlerësohem shumë. Jashtë spitalit jo edhe aq. Flitet shumë për mjekët, por jo edhe për personelin e pastrimit. Edhe pse ne kujdesemi që të plotësohen kushtet higjienike, pa të cilat spitalet nuk mund të funksionojnë – po, këtu gjithmonë ka shumë shkaktues sëmundjesh, jo së fundi shkaku i faktit të koronavirusit.

Koronavirusi nuk ka ndryshuar aspak punën time. Qysh edhe më herët unë dezinfektoja gjithçka shumë mirë dhe përiqesha të mënjanojë kontaktet. Fjala është për shëndetin e fëmijëve! Tani kujdesem më shumë edhe për veten time. Pasi ne të gjithë kemi përgjegjësi edhe karshi të tjerëve. Unë mendoj edhe në fëmijët e mijë, ata kanë nevojë për prindër të shëndoshë. Shkaku i tyre duhet edhe unë të kujdesem për veti.



Lília, fuqi pastruese në spital

Renata, mësuese e kopshtit të fëmijëve

Në Poloni kam punuar si mësuese në shkollë fillore. Në Zvicër kam ardhur në vitin 1997. Fillimisht kam punuar në një restorant, deri sa kam kryer kurset e nevojshme të mëtejme trajnuese dhe kam gjetur një punë si edukatore e fëmijëve të vegjël. Ka 16 vite që punoj në të njëjtin kopsht fëmijësh në Bernë. Unë e dua profesionin tim dhe me shumë kënaqësi e kaloj kohën me fëmijë. Shkaku i krizës së koronës, në të vërtetë vijnë vetëm pak fëmijë në kopsht. Puna kë pësuar ndryshime. Fillimisht kisha pakëz frikë. Unë jam në moshën 56 vjeçe dhe shkaku i shtypjes së lartë të gjakut i takojë grupit të të rrezikuarve. Për këtë arsye, fillimisht isha e pasigurte dhe nuk dija se a duhet të punoja më tej apo jo.

Pos kësaj nuk kuptoja, pse ishte aq e nevojshme mbyllja e shkollave, ndërsa kopshtet e fëmijëve të punonin më tej. Para së gjithash nuk kuptoja, se si unë të mbaja distancën prej 2 metrash me një fëmijë 4 vjeç, i cili më ndiqte për të më zënë. Apo si duhet ti ndërroja pelenat një fëmije dhe njëkohësisht të qëndroja në distancë. Kjo natyrisht se nuk është e mundur. Pikërisht fëmijët e vegjël kanë nevojë për afërsi fizike. Distanca 2 metrash tek ne nuk respektohet. Çka është e vërteta ne mund të kujdesemi vetëm për 10 fëmijë. Nga ana tjetër, është emocionuese të punosh me grupe kaq të vogla. Ka më shumë kohë për punë individuale me fëmijë dhe rutina e përditshme mund ta përshtatet në mënyrë individuale dhe të promovohen në mënyrë më specifike aftësi të caktuara. Dhe ka shumë më pak zhurmë. Prindërit tani më nuk kanë të drejtë të hyjnë në kopshtin e fëmijëve. Ata i sjellin fëmijët e tyre, i lajnë duart bashkë dhe shkojnë në vendet e tyre të punës, ku shkaku i pandemisë janë më se të nevojshëm. Është një ndjenjë e mirë të dimë se përmes punës sonë ne mbështesim të gjithë njerëzit që në këtë kohë kryejnë detyra të rëndësishme për shoqërinë. Por tashmë më mungojnë edhe fëmijët e tjerë.



Renata, mësuese e kopshtit të fëmijëve

Çdo ditë pyes veten, kur do të bëhet përsëri jeta jonë normale. Dikur dua të kthehem në Portugali. Unë e kam ndjenjën se puna e migranteve/ëve në Zvicër nuk vlerësohet me të vërtetë – edhe përkundër faktit se ne kujdesemi që shumëçka të funksionojë si duhet. Ndoshta është shkaku i gjuhës. Kush nuk e flet gjuhën këtu, është në disfavor. Unë kam mësuar gjermanishten, mirëpo nuk kam aftësinë shprehëse dhe bindëse sikur në portugalisht. Jetësimi i ëndrrave personale është tejet e vështirë, kur njeriu gjuhësisht nuk është i barabartë. Në portugalisht unë ndihem në shtëpinë time. Këtë mospërfillje gjuhësore dua ta arrijë përsëri, andaj dua të kthehem.

Çka duhet pasur parasysh

Prej shpërthimit të krizës së koronës janë shpeshuar thirrjet dhe pyetjet telefonike e me email në regjionet e Unia-s. Mbrojtja e shëndetit në vendin e punës, mbyllja e ndërmarrjeve, puna me kohë të shkurtuar, vazhdimi i marrjes së pagës, kërkesat që ndërlihen me përkujdesjen e fëmijëve, etj. Kanë preokupuar të punësuarit. Shumë punëmarrës janë në një gjendje të vështirë, veçanërisht ata, të cilët punojnë me pagë në orë apo me thirrje sipas nevojës. Mirëpo edhe nëse dikush punon me pagë në orë, ose në bazë të thirrjeve posedon të drejta. Në vijim disa nga pyetjet dhe përgjigjet më të rëndësishme në lidhje me këtë nga ueb faqja e Unia: www.unia.ch/coronavirus.

Unë jam i punësuar me pagë në orë. A kam të drejtë në pagë edhe nëse nuk kam mandat pune?

Në parim po, punëdhënësi ju ka borxh pagën, edhe nëse nuk kërkon punën tuaj, pavarësisht nëse jeni i punësuar në baza të përhershme ose në pagë me orë. Kushti i vetëm është që ju të keni fiksuar orarin e punës me kontratë dhe që të mos punoni për orë të tëra sipas tekave dhe në diskrecionin e shefit. Një kontratë gjithashtu mund të lidhet me gojë dhe madje në heshtje me sjellje të përshtatshme.

Kam punuar sipas porosisë, në mënyrë të parregullt, me njoftim të shkurtër. Çfarë marr unë?

Nëse keni punuar shumë në mënyrë të parregullt dhe nëse ju dhe shefi juaj keni qenë plotësisht të lirë të vendosni nëse doni të kryeni një detyrë apo jo – atëherë, nëse puna juaj nuk kërkohet më, nuk do të keni të drejtë në pagë. Nëse, nga ana tjetër, keni qenë në një ngarkesë relativisht të vazhdueshme pune për një kohë të gjatë dhe nuk keni më punë të caktuar, ju keni të drejtë në pagë. Ngase ju keni besuar se do të mund të vazhdoni të punoni edhe më tej në këtë mënyrë. Punëdhënësi duhet t'ju njoftojë për shkarkimin nëse donë t'ju jap fund pretendimit tuaj për pagë - por ju do të vazhdoni të keni të drejtë në pagë edhe gjatë afatit të shkarkimit.

Nëse punëdhënësi juaj në mënyrë të njëanshme mund të përcaktojë se kur ju do të punoni, ju keni të drejtë në pagën mesatare edhe nëse punëdhënësi papritmas ndalet për t'ju thirrur në punë. Ju gjithashtu keni të drejtë në pagën e deritashme mesatare edhe gjatë afatit të shkarkimit. Paga mesatare është paga e 12 muajve të fundit, eventualisht një kohëzgjatje më e shkurtër nëse marrëdhënia e punës ka zgjatuar më pak.

Kam punuar në bazë të porosive, nuk kam më thirrje për punë, jam i shqetësuar për pagën. Çfarë të bëjë?

Nëse ju si punëtor nuk keni më asnjë thirrje nga shefi juaj për të punuar, ne sugjerojmë procedurën e mëposhtme: Së pari, njoftoni shefin tuaj që ai është i detyruar të vazhdojë të paguajë pagat nëse plotësohen kushtet për këtë (shih më lart). Përveç kësaj, ofroni shefit tuaj punën tuaj të mëtejshme, mundësisht me shkrim. Nën titullin «Parroga? Angazhime pune të pamjaftueshme?» Unia ka vu në dispozicion shembuj mostra për raste të tilla: rebrand, ly/musterbriefe. Pastaj informoni punëdhënësin tuaj se ai gjithashtu mund të kërkojë punë me kohë të shkurtuar nëse ju plotësohen kushtet (shiko më lart). Nëse shefi nuk pranon të lajmërohet për punë me kohë të shkurtuar, lajmërohuni për përfitime të papunësisë në Entin Rajonal të Punësimin (RAV/OPR).

KËSHILLA NË PESË GJUHË: Informacione të mëtejme aktuale mbi shumë tema si fjala bie mbrojtja e shëndetit në vendin e punës, mbyllja e ndërmarrjeve, puna me kohë të shkurtuar, vazhdimi i marrjes së pagës, kërkesat që ndërlihen me përkujdesjen e fëmijëve, etj., mund t'gjeni në pesë gjuhë në www.unia.ch/coronavirus. Me pyetjet tuaja personale drejtohuni tek regjioni juaj i Unia-s. Numrin e telefonit e gjeni tek ueb faqja e njëjtë. Nëse ende nuk jeni anëtar: vegëni për lajmërim-online e gjeni gjithashtu në po këtë ueb faqe. Sa më shumë anëtarë që numëron Unia, aq më shumë mund të arrija ajo për punëmarrësit dhe punëmarrësit.

Pandemia dhe përfitimi nga sigurimi i papunësisë Papritur 120 mëditje më shumë në llogarinë e marsit

Për të mënjanuar përjashtimin nga e drejta përfituese prej fondit të papunësisë gjatë pandemisë së koronavirusit, Qeveria Federale ndër të tjera ka vendosur që personat me të drejtë përfitimi nga sigurimi i papunësisë do të marrin deri në maksimum 120 mëditje të veçanta shtesë si dhe afati i përfitimit do të zgjatet deri në maksimalisht 2 vite, nëse marrja e mëditjeve në kuadër të afatit të zakonshëm nuk është i mundur.

Në situatën aktuale mbretërore e të rëndë ekonomike, edhe shansi, për të gjetur një punë, është reduktuar së tepërmi. Për të shmangur, që gjatë krizës së koronës, personave të papunë të mos u reduktohen përfitimet e mëditjeve që atyre u takojnë, pasi tani kërkimi e gjetja e një vendi pune praktikisht është e pamundur, Qeveria Federale në kuadër të Urdhëresës mbi masat në kuadër të sigurimit të papunësisë në ndërlidhje me koronavirusin (COVID 19) ka vendosur, që personat me të drejtë përfitimi të kenë të drejtë përfitimi edhe maksimalisht 120 mëditje të veçanta shtesë dhe se afati kornizë për marrjen e përfitimit të zgjatet maksimalisht për 2 vite, përderisa nuk është e mundur marrja e plotë e përfitimit në kuadër të afatit kornizë të zakonshëm. Kështu çdo person, i cili me 01.03.2020 ende nuk e ka harxhuar të drejtën e mëditjeve, përgjatë tërë kohës të zgjatjes së Urdhëresës-COVID-19 mbi sigurimi i papunësisë, do të përfitojë maksimalisht 120 mëditje shtesë. Gjatë kësaj kohe nuk do të përdoren mëditjet normale. Përfitimi i maksimalisht 120 mëditjeve përfundon me shfuqizimin e Urdhëresës në fjalë.

A ka ndonjë gabim në llogarinë e marsit?

Shkaku i ndryshimeve të përmendura shumë të papunë janë befarsuar në fillim të prillit, kur papritur kanë parë në llogarinë e marsit, që e drejta e mbetur e përfitimit të mëditjeve është rritur, dhe përmes telefonit apo imeilit janë interesuar tek Unia. Edhe zonja C. Iu drejtua Unia të Bernës, kur në llogarinë e muajit mars të arkës së papunësisë së Unia ka parë, që e drejta e mëditjeve të mbetura papritur është rritur, gjegjësisht nga 66.4 me 28.2.2020 në 164.4 me 2.04.2020. Ajo kishte menduar, se me këtë rast është përvjedhur ndonjë gabim. Nuk ishte fjala për gabim, mirëpo është për të pasur parasysh se, tek mëditjet e veçanta shtesë, fjala është për maksimumin prej 120 ditësh.

Si përlloragiten këto ditë shtesë?

Afati kornizë për marrjen e përfitimeve zgjatet për të gjithë personat, të cilët nga 01.03.2020 janë me të drejtë përfitimi, për sa kohë vlen Urdhëresa-COVID-19 mbi sigurimin e papunësisë. Kjo kohëzgjatje do të llogaritet nga 01-03-2020 dhe ky rregullim vlen deri në shfuqizimin e Urdhëresës_COVID-19 mbi sigurimin e papunësisë. Kështu fjala bie do të dukej e drejta e përfitimit e zonjës C., nëse Urdhëresa-COVID-19 mbi sigurimin e papunësisë do të

shfuqizohet me 31.05.2020 (92 ditë kalendarike pas 01.03.2020):

Zonja C. që nga 01.05.2019 në kuadër të afatit kornizë ka edhe 66.4 mëditje përfituese (shih. foton). Ajo merr nga 01.03.2020 deri më 31.05.2020 mëditjet shtesë. E drejta e saj përfituese me 01.06.2020 është edhe më tej 66.4 mëditje.

Pra zonja C., nga maksimumi 120 mëditje shtesë ka marrë vetëm 66 (92 ditë kalendarike minus të shtunat dhe të dilet) «mëditje të koronës».

Dhe si është çështja me kërkim pune dhe përpjekje për të gjetur punë?

Detyrimi, për të kërkuar një vend pune, nuk ndryshon në parim edhe gjatë krizës së koronës, megjithatë Entet regjionale ndërmjetësuese janë inkurajuar të bëjnë këtë, gjatë bisedës për ri inkuadrim dhe strategji aplikimi, duke u përshtatur në situatën e vështirësuar. Për dëshminë e përpjekjeve për të gjetur punë, të cilat zakonisht duhet dorëzuar deri me datën 5 të muajit, është hequr dorë deri në shfuqizimin e Urdhëresës që Qeverisë Federale mbi Covid-19. Dëshmia duhet dorëzua përsëri një muaj pas përfundimit të Urdhëresës në fjalë.



Ndryshimet e të drejtës së përfitimit gjatë pandemisë



Lajmërohuni në çdo rast te Enti Regional për Punësim (RAV/ORP)

Edhe nëse nuk ju kanë shkarkuar nga puna, në bazë të rrethanave keni të drejtë në përfitim të kompensimit të papunësisë. Kjo mund të ndodhë shembullit bie me plotësimin e disa parakushteve, nëse punoni në bazë të thirrjes deh nuk ju kanë ftuar për të punuar. Për të pasur mundësi arka e papunësisë të sqarojë të drejtën e juaj përfituese, duhet të paraqitet një lajmërim. Pra, vlen «pa lajmërim s'ka përfitim». Andaj edhe në rast mëdyshjeje, ka kuptim të lajmërohuni në RAV/ORP. Çka është e vërteta arkat e papunësisë dhe entet për ndërmjetësimin e punës (RAV/ORP) janë të mbyllura, megjithatë ju lajmërimin tuaj mund ta dërgoni përmes postës apo emailit. Me rastin e lajmërimit tek RAV/ORP ju mund të përzgjidhni edhe arkën e juaj të papunësisë. Pastaj ju nga RAV/ORP do të merrni formularë të ndryshëm, të cilët duhet ti plotësoni vet ju, ose ti plotësojë punëdhënësi juaj. Më pas arka e papunësisë do të kontrollojë se a do të keni të drejtë përfitimi të parave të papunësisë. Për të shkuar kjo më shpejtë, dokumentet e dorëzuara duhet të jenë të plota. Arka e papunësisë nga ju ka nevojë:

1. Kërkesën e juaj krejtësisht të plotësuar deh të nënshkruar nga ju për kompensim të papunësisë.
2. Formularin zyrtar të lajmërimit në duplikat.
3. Vërtetimin e punëdhënësit për tri vitet e fundit, të nënshkruar nga secili punëdhënësi (nga 1 formular për punëdhënësi), një kopje të kontratës së punës të punëdhënësit të fundit, kopjet e të gjitha llogarive të mundshme të pagave, kopjen e shkarkimit nga vendi i fundit i punës.
4. Formularin e plotësuar dhe nënshkruar nga ju «Detyrimi mbajtës karshi fëmijëve».
5. Vërtetimi i lajmërimit nga komuna e vendbanimit (Dëshminë e marrjes së dërgesave).
6. Kopjen e kartës suaj bankare apo postare.
7. Formularin tërësisht të plotësuar dhe nënshkruar nga ju «Të dhënat e personit të siguruar». Ky formular ju do ta merrni përmes postës rreth datës 25 të çdo muaji. Keni parasysh ju lutem, se pa këtë formular nuk mund të bëhet pagesa.